



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Ligji Nr. 04/L-020

**PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 03/L-047 PËR
MBROJTJEN DHE PROMOVIMIN E TË DREJTAVE TË
KOMUNITETEVE DHE PJESËTARËVE TË TYRE NË REPUBLIKËN E
KOSOVËS**

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

**LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 03/L-047
PËR MBROJTJEN DHE PROMOVIMIN E TË DREJTAVE TË
KOMUNITETEVE DHE PJESËTARËVE TË TYRE NË REPUBLIKËN E
KOSOVËS**

Neni 1

Neni 1 i ligjit bazik paragrafi 1.4. riformulohet si vijon:

1.4 Për qëllimet e këtij ligji, komunitetet përkufizohen si grupe kombëtare, etnike, kulturore, gjuhësore apo fetare tradicionalisht të pranishme në Republikën e Kosovës të cilat nuk janë shumicë. Këto grupe janë komuniteti serb, turk, boshnjak, rom, ashkali, egjiptian, goran, malazez, kroat dhe komunitete të tjera. Pjesëtarët e komunitetit shumicë në Republikën e

Kosovës, të cilët si tërësi nuk janë shumicë në një komunë të caktuar po ashtu i gëzojnë të drejtat e radhitura në këtë ligj.

Neni 2

Neni 12 i ligjit bazik paragrafi 12.6. riformulohet si vijon:

12.6 Këshilli Konsultativ për Komunitete do të përbëhet nga përfaqësues të të gjitha komuniteteve të Kosovës dhe përfaqësues të Qeverisë, Zyrës së Presidentit dhe agjencive të tjera relevante. Do të ketë nga dy (2) përfaqësues të komunitetit rom, egjiptian, goran, ashkali malazet dhe atij kroat, prej të cilëve nga një (1) mund të jenë deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës. Do të ketë nga tre (3) përfaqësues të komunitetit boshnjak dhe turk, prej të cilëve nga një (1) mund të jenë deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Do të ketë pesë (5) përfaqësues të komunitetit serb, prej të cilëve dy (2) mund të jenë deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Për secilin anëtar, mund të emërohet një zëvendës anëtar. Ata anëtarë të cilët nuk janë deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës, janë zakonisht kryesues apo zëvendës kryesues apo të emëruar të tjerë të lartë të organizatave përfaqësuese të komuniteteve apo përfaqësues të shoqatave ose OJQ-ve që kanë të bëjnë me komunitetin e caktuar.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 04/ L-020
8 dhjetor 2011

Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Jakup KRASNIQI